


BULETINI MUJOR KOMUNAL



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PRESEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 267 Nr. i faq./Br.str./No.pg 27
Data/Datum/Date 04/02/2020
RAHOVEC / ORAHOVAC

KOMUNA RAHOVEC

Buletini mujor komunal është botim që përgatitet si rregull një herë në muaj dhe përmban: Aktivitetet, punët dhe angazhimet e Kryetarit të Komunës dhe drejtorëve të drejtorive komunale, të cilat janë realizuar përgjatë muajit janar.

Zyra e Kryetarit

Adresa: Rr. 8 Dëshmorët e Pashtrikut p.n, 21000, Rahovec – Kosovës

Tel : 0382004534

Email : komuna.rahovec@rks-gov.net

Janar /2020



PËRMBAJTJA

HYRJE	2
PËRMBLEDHJE E AKTIVITETEVE GJATË MUAJIT JANAR	2
Publikimi i dokumenteve me rëndësi për Komunën e Rahovecit	2
Aktivitete të rëndësishme të Kryetarit dhe drejtorëve të drejtorive janar 2020	4
PËRFUNDIM	11

HYRJE

Ky organ botues është krijuar me idenë fillestare të promovimit të aktiviteteve të Kryetarit të Komunës dhe drejtorëve të drejtorive përgjatë muajve të vitit 2020, rëndësia e botimit të buletinit disa herë në vit qëndron në dhënien e mundësisë për informacionet mbi vendimet, zbatimin e politikave dhe rezultatet e aktiviteteve të Komunës së Rahovecit në mënyrë të tillë që të mundësojmë që qytetari të ndjekë dhe të kontribuojë në mënyrë efektive në punën e institucioneve lokale.

PËRMBLEDHJE E AKTIVITETEVE GJATË MUAJIT JANAR

Publikimi i dokumenteve me rëndësi për Komunën e Rahovecit

Fillimi i vitit të ri 2020, është karakterizuar me përgatitjet rreth Planit Vjetor të Punës për vitin 2020, si dhe përgatitjen e Raportit Vjetor të Punës për vitin 2019, të dy këto dokumente janë përfunduar dhe tashmë i gjeni të publikuara edhe në ueb- faqen e Komunës së Rahovecit.

Në bazë të Statutit të Komunës së Rahovecit dhe rregulloreve në fuqi, Komuna e Rahovecit ka hartuar Planin Vjetor të Punës për vitin 2020 duke u bazuar në prioritetet strategjike dhe nevojave të adresuara nga qytetarët e komunës sonë, planin mund ta gjeni të publikuar në linkun: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2020/01/Plani-i-punes-se-kryetarit-te-komunes-dhe-qeverise-komunale-per-vitin-2020.pdf>

Raporti Vjetor i Punës për vitin 2019 është publikuar më datë: 9 janar 2020 dhe mund ta gjeni në linkun: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2020/01/Rsapor-t-vjetor-i-punes-se-qeverise-komunale-per-vitin-2019.pdf>.

Komuna e Rahovecit, ka publikuar Draft Planin Komunal të Veprimit për Eficiencë të Energjisë PKVEE-2019-2021 dhe Planin Lokal për Veprim në Mjedis 2019-2024, në vegëzën: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/rahovec-4/debat-publik/> . Propozimet, sugjerimet dhe vërejtjet për plotësim ndryshim mund të paraqiten në Zyrën e drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit e cila gjendet në katin e parë në objektin e ri të Administratës Komunale në Rahovec.



LISTA E VENDIMEVE TË NËNSHKRUARA NGA KRYETARI I KOMUNËS SË RAHOVECIT, Z.SMAJL LATIFI PËR MUAJIN JANAR 2020.

Vendimet e Kryetarit të Komunës së Rahovecit i gjeni të publikuara në ueb-faqen e Komunës së Rahovecit.

Nr	Nr.protokolit i vendimeve të Kryetarit Smajl Latifi dhe datat e marrjes së vendimeve
1	02/200/2020 Datë: 08/01/2020
2	02/201/2020 Datë:08/01/2020
3	02/202/2020 Datë: 08/01/2020
4	02/215/2020 Datë: 13.01.2020
5	02/216/2020 Datë: 13/01.2020
6	02/217/2020 Datë: 14.01.2020
7	02/218/2020 Datë: 17.01.2020
8	02/220/2020 Datë: 17.01.2020
9	02/224/2020 Datë: 20.01.2020
10	02/228/2020 Datë: 20/01/2020
11	02/229/2020 Datë: 20/01/2020
12	02/238/2020 Datë: 23/01/2020
13	02/240/2020 Datë: 24.01.2020
14	02/241/2020 Datë:27/01/2029
15	02/242/2020 Datë: 28/01/2020
16	02/243/2020 Datë: 28/01/2020
17	02/245/2020 Datë: 29/01/2020
18	02/246/2020 Datë: 29/01/2020
19	02/261/2020 Datë: 31/01/2020

Aktivitetet të rëndësishme të Kryetarit dhe drejtorëve të drejtorive janar 2020



Së bashku me anëtarë të Këshillit të Bashkësisë Islame në Rahovec, respektivisht me kryetarin e këshillit, hoxhë efendi Shani Sylka, Kryetari Smajl Latifi ka nënshkruar marrëveshje mirëkuptimi për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për qytetarët e komunës së Rahovecit. Qëllimi i marrëveshjes është kryerja e të gjitha veprimeve të domosdoshme të varrimit sipas specifikave të cekura në marrëveshje.

Kryetari Smajl Latifi i shoqëruar nga drejtori i Inspektoratit, z. Besnik Hoti dhe drejtori i Urbanizmit, z. Rumir Zhuniqi mbajtën takim me inspektorët komunal. Qëllimi i takimit ishte forcimi dhe shtimi i inspektimeve. Kryetari ka kërkuar nga inspektorët komunal që të jenë me operativ në terren, në zbatim të plotë të ligjit me qëllim të krijimit të kushteve më të mira higjeno-sanitare, mbrojtjes së mjedisit, për rend dhe rregull urbanistik etj.



Në praninë e drejtorit të Shërbimeve Publike, z. Përparim Krasniqi, Kryetari Latifi ka pritur në takim përfaqësuesit e UNDP-së me qëllim rast ka nënshkruar marrëveshje për mbështetje të projektit të kanalizimit fekal në fshatin Kramovik. Me këtë marrëveshje, UNDP shpreh gatishmëri për zgjerimin e rrjetit të kanalizimit në fshatin Kramovik, ku Komuna merr pjesë në këtë projekt, me 20 %.

Komuna e Rahovecit, respektivisht Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, bazuar në propozimet e shqyrtuara nga komisioni i caktuar për përzgjedhjen e sportistëve më të dalluar, ka përzgjedhur Sportistin e Vitit 2019 dhe ka shpërblyer të gjithë ata që kanë treguar rezultate gjatë vitit, pa dallim, në të gjitha sportet.





Kryetari Smajl Latifi bashkë me drejtorin e Arsimit, z. Avni Morina pritën në takim këshillin e prindërve të Çerdhes "Tulipanët" në Rahovec. Ata ishin të interesuar që të funksionalizohet sa më shpejt objekti i ri, i cili është në ndërtim e sipër. Dihet tashmë që ndërtimin e kësaj çerdheje e bën Ministria e Arsimit në bashkëpunim me Bankën Botërore. Edhe ne si Komunë, respektivisht si drejtori e Arsimit kemi vëzhguar nga afër punimet, jemi në kontakt të vazhdueshëm me operatorin dhe jemi të interesuar që çerdhja të vihet në funksion dhe fëmijët të kenë një çerdhe me të gjitha standardet.

Komuna e Rahovecit, respektivisht drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ka bërë shpërndarjen e fazës së 5-të të mekanizmave bujqësorë. Në këtë fillimvit, nga kjo fazë e shpërndarjes, 53 fermerë kanë përfituar mekanizma bujqësorë, të cilët përfshijnë: 53 pajisje: 10 freza me gjatësi 3 metër, 6 freza me gjatësi 1.8 metër, 5 freza me gjatësi 1.6 metër dhe 32 mulqere të hardhive. Gjatë fazës tjetër të shpërndarjes, e cila pritët të bëhet në fillim të muajit shkurt, do të shpërndahen motokultivatorë.



Është praktikë e zakonshme e Kryetarit Smajl Latifi që pasditen e së enjtes, t'ju kushtojë të gjithë qytetarëve të komunës së Rahovecit, për të shprehur kërkesat, nevojat dhe shqetësimet që ata kanë.

Kompleksi Përkujtimor në Kodër të Gradishit.





Është finalizuar synimi 19 vjeçar- Licencimi i Zonës Ekonomike - Parkut Industrial në komunën e Rahovecit. Me themelimin e Zonës Ekonomike, respektivisht Parkut Industrial në Opterushë përmbushet një kërkesë e kahmotshme e bizneseve të komunës së Rahovecit për një hapësirë të lirë ku do të zhvillohen veprimtari të ndryshme ekonomike. Me krijimin e kësaj zone ekonomike kemi për qëllim nxitjen dhe inkurajimin e investimeve të investitorëve të huaj dhe vendor, bizneseve vendore, të cilat do të vendosen në këtë zonë, duke mundësuar kështu edhe hapjen e vendeve të reja të punës.

Si një nga problematikat e vazhdueshme të zonave bujqësore, janë rrugët e mbyllura të cilat krijojnë vështirësi në qasjen e fermerëve në tokat e tyre kultivuese. Në fshatin Drenoc janë duke u rregulluar rrugët fushore në të cilën do të përfshijnë sipërfaqe mbi 100 ha, ku pjesa më e madhe është e mbjellur me vreshta dhe me kultura të ndryshme.



Gjatë muajit janar drejtori i Bujqësisë z. Berat Duraku ka takuar operatorët ekonomik që kanë kontratë me Komunën e Rahovecit konkretisht me Drejtorinë e Bujqësisë për implementimin e projektve të ndryshme. Në takime është diskutuar për punët që janë zhvilluar gjatë vitit 2019, si dhe për dinamikën dhe vazhdimin e punëve të cilët do të zhvillohen për vitin 2020.



Drejtori i Bujqësisë z. Berat Duraku, së bashku me drejtorin e Urbanizmit z. Rumir Zhuniqi, vizituan fermerin Baki Gashi në Bratotin, Bakiu është përfitues i grantit nga MBPZHR, ku për të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për aplikim së bashku me projektin dhe planin e biznesit është përkujdesur kompania konsulente të cilën e ka kontraktuar Komuna e Rahovecit. Angazhimi i kompanive konsulente ka dhënë rezultat të mahnitshëm dhe do të vazhdojë edhe në vitet e ardhshme!





Është mbajtur trajnimi i Ekipeve të Vlerësimit të Brendshëm të shkollave të komunës sonë. Ky trajnim është zhvilluar me temën bosht "Vlerësimi i performancës së shkollave". Përgjatë 6 ditëve janë trajnuar ekipet e të gjitha shkollave.



Duke parë gjendjen e keqe dhe të shkatërruar të parketit të sallës së edukatës fizike në Shkollën e Mesme Profesionale "Selajdin Mullabazi-Mici", u interesuam dhe u përkushtuam që sa më shpejtë të bëjmë riparimin e dyshemesë së saj. Për këtë qëllim investuam në të dhe sot kjo sallë është e gatshme për zhvillimin e aktiviteteve sportive për nxënësit e kësaj shkolle.

Si rezultat i bashkëpunimit të DKA-së me Kontigjentin e Kfor-it Italian, në shkollën "Gëzim Hamza-Piktori" në Rahovec u realizua një dhuratë e çmuar. Kfori Italian dhuroi pajisje laboratorit të fizikës për arsimtarët dhe nxënësit e kësaj shkolle në vlerë prej 800 €.



Drejtori i DKA së z.Avni Morina ka realizuar një takim me menaxheren e projektit "SHPRESE" të Caritas-it të Zvicrës znj. Krenare Lleshi.

Në këtë takim është biseduar për fillimin e realizimit të këtij projekti, përmes të cilit do të bëhet e mundur pajisja me inventar e 6 klasave parafilllore në shkollat e komunës sonë dhe trajnimi i edukatoreve për procesin edukativ të fëmijëve të moshave 0 deri 6 vjeç.



Drejtori i DKA-së z. Avni Morina ka vizituar shkollën "Gëzim Hamza-Piktori" në qytet, me ç'rast u njoh nga afër me gjendjen e dysHEMEVE të klasave dhe NYJEVE SANITARE.

Në kuadër të zbatimit të projekteve për riparime në shkolla, do të angazhohemi që të bëjmë riparimet e nevojshme edhe në këtë objekt shkollor, në mënyrë që të përmirësojmë gjendjen infrastrukturore të kësaj dhe disa shkollave të tjera që kanë nevojë, potencoi ai.

Një punë e vogël, por shumë e rëndësishme në fshatin Celinë. Projekti ka për qëllim eliminimin e rrezikut permanent nga lëvizja e veturave në kryqëzimin Celinë - Fortesë, duke i shtuar një aneks rrugor në këtë kryqëzim.



Foto të realizuara nga punimet në segmentin e rrugës "Sabit Shabandula" në Rahovec. Është larguar rrjedha e kanalizimit fekal nga lumi Duhillo dhe është vendosur në kolektor.



Vijojnë punimet e ndërtimit të objektit të shkollës fillore "Liria" në Fortesë.



Është duke vazhduar me sukses procesi i legalizimit të objekteve pa leje në Komunën e Rahovecit. Drejtori i DUPMM-së z.Rumir Zhuniqi ka ftuar të gjithë pronarët e objekteve pa leje, si ato të banimit apo afariste, që ta shfrytëzojnë mundësinë për legalizim, sipas Ligjit të Ri për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje.



Në Shtëpinë e Kulturës "Mensur Zyberaj", është mbajtur manifestimi përkujtimor e kulturor për shënimin e 30 vjetorit të rënies së dëshmorëve Nesimi Elshani, Agron Fetahu, Halim Hoti dhe Hilmi Krasniqi. Gjatë këtij aktiviteti është promovuar libri "Shtegtari i Lirisë", i autorit Qemajl Krasniqi, kushtuar dëshmorit Nesimi Elshani, janë shpallur rezultatet e konkursit letrar "Pena e Flakës së Janarit", si dhe është organizuar ekspozita në bashkëpunim me OJQ Art Studio. Aktivitetet janë mbajtur në kuadër të "Flakës së Janarit".



Drejtoresha e DKRS-së znjsh. Bjondina Kleqka vizitoi klubin dhe shkollën e futbollit FC Anadrini, stafi i FC Anadrini, me përkushtimin dhe seriozitetin e tyre kanë ndikuar në motivimin e një numri të madh të fëmijëve dhe të rinjëve, dhe në këtë mënyrë është rritur edhe më shumë interesimi i të rinjëve, të përfshihen me këtë disiplinë sportive.



Komuna e Rahovecit, përkatësisht Drejtoria e Shëndetësisë, është përfituese e 2 EKG për nevojat e QKMF-së në Rahovec . Ky donacion ka ardhur si rezultat i bashkëpunimit të mirë që kemi pasur me kontigjentin Italian të KFORIT. Donacione të tilla funksionalizojnë edhe më shumë QKMF-në, si dhe na shërbejnë neve si drejtori të japim shërbime sa më cilësore dhe efikase për gjithë qytetarët e komunës tonë.

Disa nga projektet infrastrukturore në komunën tonë, gjatë muajit janar nga Drejtoria e Shërbimeve Publike:

- 1.Ndërtimi i dy segmenteve rrugore në Bratatin;
- 2.Ndërtimi i dy segmenteve rrugore, një në Çifllak dhe njëri segment në Xërxë;
- 3.Ndërtimi i rrugës "Beteja e Gradishit" në Gexhë;
- 4.Kanalizimi i ujërave fekale në rrugën "Sabit Shabandula" në Rahovec;
- 5.Kanalizimi i ujërave fekale në rrugën "Agim Qelaj" në Rahovec;
- 6.Kanalizimi i ujërave fekale në fshatin Pataqan i Epërm;
7. Ndërtimi i rrugës Xërxë-Sapniq-Ratkoc.



Në mbledhjen e Kuvendit Komunal të Rahovecit, miratuam BUXHETIN për vitin fiskal 2020. Si rrjedhojë, ky buxhet është mundësi reale për vazhdimin e përpjekjeve për përmbushjen e planit tonë për vitin 2020, në shërbim të qytetarëve të komunës së Rahovecit. Buxheti i përgjithshëm për vitin 2020 është 14,735,841.00 €, ku nga të hyrat vetanake të planifikuara kemi: 1,156,841.00 €. Për: Paga dhe Mëditje janë: 8,644,220.00 €, Mallra dhe Shërbime: 1,594,330.00 €, Shpenzimet komunale: 280,500.00 €, Subvencione dhe Transfere: 311,000.00 €, Investime kapitale :3,905,770.00 €.

PËRFUNDIM

Ky buletin përmbledhës paraqet thekset kryesore të aktiviteteve që kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe (janar 2020).

Edhe pse fusha e qeverisjes së mirë është mjaft e gjerë, një aspekt i rëndësishëm i saj që është i pashmangshëm për ta plasuar qytetarin në vend qendror është liria e informimit. Informacioni është themeli i qeverisjes së mirë, jo vetëm sepse e rrit efikasitetin por gjithashtu sepse i fuqizon qytetarët dhe mundëson shpërndarje të barabartë të përfitimeve nga zhvillimi i përgjithshëm në vend, andaj duke dashur që të jetë sa më transparente me publikun, Komuna e Rahovecit përmes këtij dokumenti ka ofruar një pasqyrë të përgjithshme të aktiviteteve të saj, për t'iu dhënë mundësi qytetarëve që të njohin e vlerësojnë punën e institucioneve komunale.

Në nivelin lokal, mekanizmi i pjesëmarrjes së qytetarëve në bërjen e politikave është kriter bazë i demokracisë së drejtpërdrejtë të cilin duhet respektuar njësitë e vetëqeverisjes lokale.

Komuna e Rahovecit ka vënë në funksion këto parime përmes formave të ndryshme të komunikimit me qytetarë, takimeve të drejtpërdrejta, informimit publik dhe çfarëdo metode tjetër përmes së cilës transparenca të ndikojë në avancimin e vetëqeverisjes lokale.

Përveç konsultimit dhe komunikimit, këto dokumente forcojnë lidhjet e qytetarëve me komunën dhe rrisin besimin që e gëzojnë zyrtarët publik në nivel lokal.

Rahovec, 4 shkurt 2020

Zyra e Kryetarit

Komuna e Rahovecit/Opština Orahovac/Municipality of Rahovec

Adresa : Rr. 8 Dëshmorët e Pashtrikut p.n,21000,Rahovec –Kosovës Tel :0382004534 Email : komuna.rahovec@rks-gov.net